

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**PPL – KZZ 12/08****19 mars 2009**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Norbert Koster si Kryetar i trupit gjykues dhe nga gjyqtarët e EULEX-it Guy Van Craen dhe Emilio Gatti si anëtarë të kolegjit, në praninë e procesmbajtësit Mircea Cristian Nicoara, në rastin penal K.A. nr. 33/05 të Gjykatës Komunale të Pejës kundër të pandehurve **Gani Kelmendi** dhe **Florim Zekaj**,

të dy të dënuar për veprën penale të Detyrimit (sipas nenit 267, paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës – tash e tutje do t'i referohemi si KPPK) dhe të pandehurit Florim Zekaj, gjithashtu i dënuar për kryerjen e veprës penale Tentativë për pengimin e të provuarit (neni 309, paragrafi 1, në lidhje me nenin 20, paragrafi 1 i KPPK-së),

duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitura nga avokatët mbrojtës Orhan Basha dhe Zivojin Jokanovic në emër të të pandehurit Gani Kelmendi dhe nga avokati mbrojtës Adem Gorani në emër të të pandehurit Florim Zekaj, të tri këto kërkesa të drejtuara kundër aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë më 10 tetor 2007 (Ap. nr. 62/2007),

lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitura më 19 nëntor, 26 nëntor dhe 11 dhjetor 2007 kundër aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë më datën 10 tetor 2007 (Ap. Nr. 62/2007) **hedhen poshtë si të pabaza.**

ARSYETIM

I. Ana procedurale

Gani Kelmendi ka qenë gjyqtar në Gjykatën Komunale të Istogut, përgjegjës për ekzekutimin e aktgjytimeve. Një nga rastet e tij ishte ekzekutimi i aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Komunale në Istog më 15 prill 2002, përmes së cilit debitori Arif Haskaj ishte i detyruar që t'i paguajë €23,000 kreditorit Ismet Blakaj. Gjatë procedurave të përmbarimit lindi dyshimi se Gani Kelmendi së bashku me Florim Zekajn kanë kërcënuar Ismet Blakajn me shtyrje të përmbarimit po qe se Ismet Blakaj do të refuzonte t'i paguante €1,000 Gani Kelmendit.

Hetimet kundër Gani Kelmendit dhe Florim Zekajt filluan, dhe më 14 janar 2005, në bazë të nenit 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/6, të ndryshuar me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 2000/34 dhe 2001/2, e cila i autorizon prokurorët ndërkombëtarë të përzgjedhin dhe të marrin përgjegjësi për hetime dhe procedura të reja dhe të hapura penale, Prokurori ndërkombëtar i qarkut në Pejë zgjodhi këtë rast për hetim dhe për ndjekje penale kundër të pandehurve.

Më 25 mars 2005, pas një procesi hetimor, Prokurori ndërkombëtar në Pejë ia paraqiti Gjykatës së Qarkut në Pejë aktakuzën kundër të dy të pandehurve.

Më 5 maj 2005, duke vepruar sipas kërkesës së Gjykatës Komunale në Istog, Gjykata e Qarkut në Pejë ka caktuar Gjykatën Komunale në Pejë si gjykatë kompetente që ka juridiksion në këtë rast.

Më 27 korrik 2005, Gjykata Komunale në Pejë mbajti seancën e konfirmimit. Të pranishëm ishin Gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës Sejdi Blakaj, Prokurori komunal Gezim Baloku si dhe të pandehurit. Pas një seance të shkurtër, Gjyqtari për konfirmim Blakaj hodhi poshtë aktakuzën kundër të pandehurit Gani Kelmendi ndërsa konfirmoi aktakuzën kundër të pandehurit Florim Zekaj.

Zyra e Prokurorit ndërkombëtar në Pejë (apo gjëkund tjetër) as nuk është lajmëruar as nuk është ftuar në seancën për konfirmim të aktakuzës, të mbajtur më 27 korrik 2005. Për më tepër, aktgjykimi i datës 27 korrik 2005 nga ana e gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës Blakaj për hedhjen poshtë të akuzave kundër të pandehurit Gani Kelmendi nuk i është dorëzuar Zyrës së Prokurorit ndërkombëtar në Pejë.

Më 8 gusht 2005, Prokurori ndërkombëtar ka paraqitur ankesë ndaj aktgjykimit mbi hedhjen poshtë të aktakuzës kundër të pandehurit Gani Kelmendi.

Më 22 gusht 2005, në bazë të vendimit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të datës 12 gusht 2005, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë ka caktuar tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë për të shërbyer në kolegjin e Gjykatës Komunale në Pejë, për të vendosur mbi ankesën e Prokurorit ndërkombëtar.

Më 26 gusht 2005, kolegji prej tre gjyqtarësh ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë, PP. Nr. 20/05, të datës 27 korrik 2005, i cili kishte hedhur poshtë

aktakuzën kundër të pandehurit Gani Kelmendi. Ky kolegji ka kthyer rastin për rishqyrtim dhe ka urdhëruar caktimin e seancës së re për konfirmimin e aktakuzës.

Më 7 tetor 2005, i pandehuri Gani Kelmendi ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë, KA. Nr. 33/05 të datës 26 gusht 2005.

Më 3 tetor 2005, Gjykata Komunale në Pejë ka mbajtur seancë të re publike mbi konfirmimin e aktakuzës, para gjyqtarit ndërkombëtar. Kjo aktakuzë kundër të dy të pandehurve është konfirmuar më datën 14 tetor 2005.

Më 29 nëntor 2005, Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga i pandehuri Gani Kelmendi.

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Pejës më 24 mars 2006, të dy të pandehurit janë shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale të detyrimit (neni 267, paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të KPPK-së). I pandehuri Florim Zekaj po ashtu është dënuar për kryerjen e veprës penale tentativë për pengimin e të provuarit (neni 309, paragrafi 1, në lidhje me nenin 20, paragrafi 1 i KPPK-së). Të dy të pandehurit janë dënuar me tre (3) vjet burgim. Përveç kësaj, të pandehurit Gani Kelmendi i është marrë e drejta e ushtrimit të profesionit të gjyqtarit për një periudhë prej pesë (5) vjetësh, pas vuajtjes së plotë të dënimit.

Të dy të pandehurit kanë ushtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi. Gjykata e Qarkut në Pejë me aktgjykimin e datës 10 tetor 2007 ka hedhur poshtë këto ankesa dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i datës 10 tetor 2007 u është dorëzuar të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës më datën 17 tetor 2007.

Më 22 nëntor 2007, avokati mbrojtës Orhan Basha në emër të të pandehurit Gani Kelmendi ka paraqitur në Gjykatën Komunale të Pejës kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 19 nëntor 2007, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës.

Më 26 nëntor 2007, avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic në emër të të pandehurit Gani Kelmendi ka paraqitur në Gjykatën Komunale të Pejës kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 26 nëntor 2007, kundër aktgjykimit të cekur më lart.

Më 11 dhjetor 2007, avokati mbrojtës Adem Gorani në emër të të pandehurit Florim Zekaj ka paraqitur në Gjykatën Komunale të Pejës kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 11 dhjetor 2007, kundër aktgjykimit të përmendur.

Kërkesat janë përcjellë në Gjykatën Supreme të Kosovës më 13 shkurt 2008 dhe rasti është dërguar në ZPPK, dhe prokurori më 20 janar 2009 ka dorëzuar mendimin e tij të datës 16 janar 2009.

Çështjet e ngritura lidhur me ankesën në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nga avokati mbrojtës Orhan Basha

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Orhan Basha, pohon shkelje të ligjit penal, shkelje thelbësore të Ligjit mbi procedurën penale dhe shkelje të tjera të ligjit mbi procedurën penale.

Ai pohon se:

1. As Gjykata Komunale as ajo e Qarkut në Pejë nuk kanë mundur të konstatojnë nëse vepra për të cilën është dënuar Gani Kelmendi ka qenë vepër penale apo jo. Avokati Basha pohon se i pandehuri Gani Kelmendi nuk kishte shtyrë përmbarimin (ekzekutimin) e aktgjykimit civil, i cili deri më sot akoma nuk është përmbaruar. Përveç kësaj, ai nuk kishte përdorur forcë. Në këtë kuptim, avokati mbrojtës Basha ankohet, siç pohon ai, për mungesën e arsytimit në këtë aktgjykim. Për më tepër, ai pohon se kjo vepër penale ka mund të kualifikohet vetëm si tentativë e detyrimit.
2. Aktgjykimi është mbështetur në dëshmi të papranueshme. Përgjimi dhe regjistrimi brenda dhe jashtë kafenesë më datën 15 shkurt 2005 janë bërë përmes një urdhri të paligjshëm. Nuk kishte pasur dyshime të bazuara që i pandehuri Gani Kelmendi kishte kryer vepër penale e cila ishte e dënueshme me së paku katër vjet burgim.
3. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe se këtij aktgjykimi i mungon arsytimi përkitazi me faktet vendimtare bindëse.
4. Procedurat kishin përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Pejës më datën 27 gusht 2005, e cila kishte hedhur poshtë aktakuzën.

Në fjalën e tij përmbyllëse, avokati mbrojtës Orhan Basha kërkon nga Gjykata Supreme që ta ndryshojë aktgjykimin përfundimtar dhe ta lirojë të pandehurin Gani Kelmendi apo ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë rastin për rigjykim.

Çështjet e ngritura lidhur me ankesën në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nga avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic, pohon shkelje të ligjit penal, shkelje thelbësore të Ligjit mbi procedurën penale dhe shkelje të tjera të ligjit mbi procedurën penale.

Ai pohon se:

1. I pandehuri Gani Kelmendi nuk ka kryer veprën penale të detyrimit për arsye se nuk ka mundësi të përdoret forca apo kërcënimi në mënyrë indirekte.
2. I pandehuri Gani Kelmendi është shpallur fajtor për kryerje të veprës së detyrimit, edhe pse Prokurori Publik kishte ndryshuar akuzat dhe kishte ri-kualifikuar veprën vetëm si një tentativë të detyrimit.
3. Aktgjykimi ishte mbështetur në dëshmi të papranueshme, për arsye se i pandehuri Gani Kelmendi ishte shpallur fajtor për një vepër penale që nuk lejonte masa të fshehta.
4. Procedurat kishin vazhduar përkundër hedhjes poshtë të aktakuzës përmes aktgjykimit përfundimtar të Gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës.

Në fjalën e tij përmbyllëse, avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic kërkon nga Gjykata Supreme që ta ndryshojë aktgjykimin përfundimtar dhe ta lirojë të pandehurin Gani Kelmendi apo ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë rastin për rigjykim.

Çështjet e ngritura lidhur me ankesën në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nga avokati mbrojtës Adem Gorani

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Adem Gorani, pohon shkelje të ligjit penal, shkelje thelbësore të Ligjit mbi procedurën penale dhe shkelje të tjera të ligjit mbi procedurën penale. Kërkesa e tij pothuaj në tërësi pasqyron kërkesën e paraqitur nga avokati mbrojtës Orhan Basha. Prandaj, me qëllim që t'i shmangemi përsëritjes së gjërave të njëjta, i referohemi kërkesës së paraqitur nga avokati Orhan Basha.

Vetëm këto pohime shtesë ia vlejné të përmenden:

1. Se i pandehuri Florim Zekaj nuk ka kryer veprën penale të detyrimit, sepse ai nuk ka përdorur as forcë as kërcënim. Përkundrazi, qëllimi i tij ishte ta ndihmonte Ismet Blakajn.
2. Se tentativa për pengimin e të provuarit nuk ekziston, sepse sipas nenit 20, paragrafit 2 (avokati nuk përmend cilit ligj po i referohet), dënimi më i vogël i paraparë me ligj duhet të jetë tre (3) vjet.

Në fjalën e tij përmbyllëse, avokati mbrojtës Adem Gorani kërkon nga Gjykata Supreme që ta ndryshojë aktgjykimin përfundimtar dhe ta lirojë të pandehurin Gani Kelmendi apo ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë rastin për rigjykim.

Mendimi i Zyrës së Prokurorit Publik të Kosovës (ZPPK), i datës 16 janar 2009

ZPPK-ja, duke iu referuar në mënyrë specifike kërkesave të paraqitura në emër të të pandehurit Gani Kelmendi, shpreh mendimin e saj që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pabaza, duke u mbështetur në atë se çështjet e ngritura në këto kërkesa janë kryesisht të njëjta me ato që janë ngritur gjatë shqyrtimit kryesor. Argumentet e parashtruara nga avokatët mbrojtës ishin shqyrtuar edhe më herët dhe ishin hedhur poshtë. Nuk janë paraqitur autoritete bindëse ligjore, të cilat do të rezultinin me ndryshime të gjetjeve të konstatuara më herët.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

1.

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të papranueshme.

Të tri (3) kërkesat janë paraqitur në gjykatën kompetente sipas nenit 453, paragrafit 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 452, paragrafin 3 të KPPK-së.

2.

Gjykata Supreme ka vendosur në seancë, siç përcaktohet me nenin 454, paragrafin 1 të KPPK-së. Njoftimi i palëve përkitazi me këtë seancë, siç është kërkuar nga avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic, nuk ka qenë i nevojshëm. Dispozitat e nenit 451 deri në nenin 460 të KPPK-së nuk përmbajnë ndonjë rregull, e cila do ta obligonte Gjykatën Supreme që t'i njoftojë palët. Kolegji nënvizon se ligji nuk i referohet nenit 410, paragrafit 1 të KPPK-së, përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë. Përveç kësaj, sipas nenit 455 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës në vlerësimin e saj është e kufizuar në argumentet e ngritura nga palët në kërkesat e tyre.

Kolegji nuk ka qenë i detyruar që të vendosë nëse në raste të jashtëzakonshme palët mund ta kenë të drejtën që të jenë të pranishëm apo jo, edhe pse ligji nuk përcakton një prani të tillë. Rasti në fjalë mund të jetë gjithçka tjetër por jo edhe i jashtëzakonshëm. Arsyet e parashtruara nga avokatët mbrojtës janë në tërësi të njëjta me ato të paraqitura dhe të diskutuara gjerësisht gjatë dy seancave të shqyrtimit kryesor. Është e qartë se nuk ka nevojë për diskutime të mëtejshme verbale dhe për këtë arsye nuk ka nevojë që të vlerësohet nëse dhe në çfarë rrethanash mund të ekzistojë e drejta e jashtëzakonshme e palëve që të jenë të pranishëm apo jo në seancën e kolegjit.

3.

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pabaza.

a. Shkeljet e pohuara të ligjit penal

Argumenti i parashtruar se gjoja gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë mundur që t'i konstatojnë faktet, për të cilat të pandehurit janë dënuar, si vepra penale, është i pakuptueshëm.

Çështjet ligjore në të dy aktgjykimet janë trajtuar në një mënyrë të plotë dhe bindëse. Pohimet e avokatëve mbrojtës se këto gjetje të gjykatës janë në kundërshtim me dëshmitë, në këtë fazë janë të papranueshme sipas nenit 451, paragrafit 2 të KPPK-së.

Pohimi se shtyrja e shpallur në ekzekutimin e aktgjykimit nuk mund të konsiderohet si një kërcënim, nuk është i vlefshëm. Ismet Blakaj ishte i varur nga puna e të pandehurit Gani Kelmendi përkitazi me ekzekutimin e aktgjykimit civil. Në një situatë të tillë, shtyrja e shpallur e ekzekutimit ishte një keqpërdorim i pozitës me që kishte si qëllim – të suksesshëm – shkaktimin e frikës tek Blakaj se nuk do t'i merrte paratë që i takonin. Kjo është qartë dhe pa asnjë dilemë një kërcënim serioz. Në këtë kontekst, konstatimi se ekzekutimi i aktgjykimit civil nuk është bërë as dy vjet e gjysmë pas largimit të të pandehurit Kelmendi prej zyrës, mbështetet në të kuptuarit e pasaktë të ligjit. Pavarësisht pyetjes se për çfarë arsye nuk ka qenë i mundur ekzekutimi i suksesshëm i këtij aktgjykimi civil, me ligj nuk kërkohet që kryerësi i veprës penale të jetë në gjendje që ta kuptojë kërcënimin. Mjafton që kryerësi ta detyrojë viktimën që të besojë se ai ka fuqi për ta jetësuar këtë kërcënim.

Konstatimi tjetër se kërcënimin nuk mund të ushtrohet në mënyrë indirekte nuk merr parasysh faktin se ligji nuk kërkon kërcënim të drejtpërdrejtë.

Më tutje, Gjykata e Qarkut në Pejë ka shtjelluar në hollësi lidhur me gjetjet ligjore se të pandehurit kanë kryer veprë të plotë të detyrimit dhe jo vetëm tentativë (shih pikën 5.3.4 të aktgjykimit). Arsyetimi i Gjykatës së Qarkut është i saktë dhe nuk përbën shkelje të ligjit penal.

Pohimi i avokatit mbrojtës Orhan Basha se Gjykata e Qarkut për këtë qëllim është dashur që ta zgjerojë aktakuzën, mbështetet në fakte të cilat nuk pasqyrojnë ngjarjet e vërteta. Për ndryshim nga përshkrimi i ngjarjeve procedurale të paraqitura nga avokatët Basha dhe Jokanovic, aktakuza nuk është ndryshuar si duhet në shkallën e dytë. Si përgjigje ndaj ankesave kundër aktgjyqimit të shkallës së parë, Prokurorja ndërkombëtare në parashtresën e saj të datës 29 gusht 2007, ka shprehur vetëm mendimin e saj që kjo vepër penale e detyrimit nuk është kryer nga të pandehurit. Ky mendim i saj, megjithatë, nuk ka pasur ndonjë karakter detyrues për Gjykatën e shkallës së dytë.

b. Shkeljet e pohuara të ligjit të procedurës penale

Përkitazi me pohimin se dënimi i të pandehurve kishte qenë i bazuar në dëshmi të papranueshme, Gjykata e Qarkut në aktgjykimin e saj ka shtjelluar në hollësi këtë temë. Gjetjet ligjore të kolegjit të Gjykatës së Qarkut janë të sakta dhe nuk lejojnë asnjë pohim për shkelje të ligjit të procedurës. Në këtë kontekst, duhet të theksojmë se pohimi i avokatit mbrojtës Orhan Basha, se gjykata e shkallës së dytë kishte refuzuar të vendosë përkitazi me pranimin e dëshmive, është thjesht i gabuar. Gjykata e shkallës së dytë ka shtjelluar në pikën 5.2.1 në mbi dy faqe (në versionin në gjuhën angleze) përkitazi me pranimin e dëshmive. Prandaj "shqyrtimi profesional" për të cilin avokati Basha beson se duhet të insistonte, vërtet tanimë ishte bërë dhe një gjë e tillë mund të vërtetohet lehtë nga vetë aktgjyqimi i gjykatës së shkallës së dytë.

Çështja nëse procedurat kundër Gani Kelmendit kishin përfunduar pas refuzimit të aktakuzës kundër tij nga ana e gjyqtarit vendor, nuk mund të ngrihet përsëri. Kjo çështje është trajtuar në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga i pandehuri Gani Kelmendi më 7 tetor 2005. Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë këtë kërkesë me vendimin e saj të datës 29 nëntor 2005. Për këtë arsye kjo çështje është zgjidhur dhe nuk mund të trajtohet sërish me një kërkesë tjetër për mbrojtje të ligjshmërisë (shih nenin 451, paragrafin 2 të KPPK-së).

Pohimi i avokatit mbrojtës Gorani se tentativa për pengimin e të provuarit nuk është vepër penale, është një pohim jomeritor. Sipas nenit 20, paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), tentativa për kryerjen e një veprë penale është e dënueshme po qe se ajo vepër penale është e dënueshme me së paku tre vjet. Sipas nenit 309, paragrafit 1 të KPK-së pengimi i të provuarit dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Në fund, kolegji vë në pah se pohimi i përgjithshëm se aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë nuk japin arsytim të mjaftueshëm, nuk është i kuptueshëm. Në veçanti aktgjyqimi i gjykatës së shkallës së dytë shtjellon më mënyrë tepër të përpiktë dhe të hollësishme secilën çështje të procedurës veç e veç si dhe ligjin material.

III. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsyt e përmendura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vjen në përfundim që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pabazuara dhe për këtë arsye, të njëjtat hedhen poshtë.

Duke u mbështetur në nenin 456 të KPPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
PPL - Kzz 12/2008, 19 MARS 2009

Procesmbajtësi:

Mircea Cristian Nicoara

Kryetari i trupit gjykues:

Norbert Koster

Anëtari i kolegjit:

Guy Van Craen

Anëtari i kolegjit:

Emilio Gatti